



A.nr.372/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi, dhe, Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.372/2026 të datës 30.03.2026 të parashtruar nga ankuesit S.M, O.Ç dhe F.Q të cilët i përfaqëson avokati Mergim Himaj nga Prishtina, kundër Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, në çështjen juridike ‘*kompensim material*’, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.372/2026 e datës 30.03.2026 e parashtruar nga ankuesit S.M, O.Ç dhe F.Q.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, S.M, O.Ç dhe F.Q (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit*), të punësuar në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent më datë 30.03.2026 përmes përfaqësuesit me autorizim avokat Mergim Hima kanë parashtruar ankesë me numër protokolli: 1586/2026 të regjistruar nën shenjën A.nr.372/2026 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e diferencës në page sipas vendimit të datës 16.02.2023 të Qeverisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 17.04.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Menaxhimit Emergjent, ndërsa kjo e fundit më datë 24.04.2026 ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1586/2026 të datës 30.03.2026 të parashtruar nga ankuesit përmes përfaqësuesit me autorizim në KPMSHCK; Autorizimin e datës 13.11.2023 lidhur me përfaqësimin e ankuesve; Dokumentet e identifikimit të ankuesve; Akt emërimit të ankuesve; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.04.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 24.04.2026; Vendimin me numër 36/2019 të datës 07.05.2019; Kërkesën e datës 13.03.2023; Listën lidhur me ekuivalentimin e zyrtareve publik sipas vendimit të Qeverisë; Vendimin me numër A.nr.118/2024 të KPMSHCK-së; Kërkesën e datës 20.02.2026 të ankuesit O.Ç drejtuar AME-së; Kërkesën e datës 20.02.2026 të F.Q drejtuar AME-së; Kërkesën e datës 19.02.2026 të S.M drejtuar AME-së;

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesi, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesit janë të punësuar në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, respektivisht ankuesi S.M sipas Akt Emërimit me shifër: AME-QOER-Gjilan 1/2013 të datës 31.01.2013 është i punësuar në pozitën e punës “Koordinator në Qendrën Operative Emergjent ”-Rajoni Gjilan, ankuesi O.Ç sipas Akt Emërimit me shifër: AME1/2013 është i punësuar në pozitën e punës “Koordinator i Shërbimeve Emergjente ”-Rajoni Prizren dhe ankuesi F.Q sipas Akt Emërimit me shifër: AME-QOER-Pejë 1/2013 është i punësuar në pozitën e punës “Koordinator në Qendrën Operative Emergjent ”-Rajoni Pejë.

Ankuesi S.M me datë 19.02.2026 përmes emalit i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Departamentit të Operatives dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore në AME, që ti bëhet ndryshimi i koeficientit nga data 02.02.2023, ndërsa me datë 20.02.2026 ankuesit O.Ç dhe F.Q me kërkesa të ndara përmes emalit i janë drejtuar po ashtu Drejtorit të Departamentit të Operatives dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore me pretendimet e njëjta lidhur me ndryshimin e koeficientit nga data 02.02.2023. Tutje organi i punësimit nuk i është përgjigjur ankuesve lidhur me kërkesat e parashtruara me datë 19.02.2026 dhe 20.02.2026.

Ankuesit, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, pozitat e Koordinatorëve të Qendrave Operative Emergjente Rajonale në Gjilan, Pejë dhe Prizren, pranë Agjencisë të Menaxhimit Emergjent, /MPB janë sistemuar në pozitë menaxheriale, Drejtues i ulët me koeficient 7.35 sipas shtojcës 10.6 ndërsa ankuesit ende janë të sistemuar në pozitën profesionale 1 me koeficient 5.7, të njëjtit po ashtu pretendojnë se me kërkesë janë drejtuar te organi i punësimit, mirëpo kjo e fundit nuk është përgjigjur kërkesave të nëpunësve.

Në kuptim të pranimit të ankesës Kolegji i Këshillit ju referua Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenit 127 Afati kohor për parashtrimin e ankesës 1. **Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.** 2. **Pala e tretë që nuk ka marrë pjesë në procedurën administrative dhe nuk i është njoftuar akti, mund të parashtrorë ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur ka marrë apo duhej të kishte marrë dijeni për aktin, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga nxjerrja e aktit.** 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashkuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj. 4. **Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë**

dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”, si dhe neni 129 Kushtet për pranueshmërinë e ankesës 1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte:

1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. **ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji**, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.

Andaj nisur nga dispozitat e lartshënuara, ankuesit kanë parashtruar ankesë në KPMSHCK në kundërshtim me dispozitat e lartshënuar, sepse ankuesit kanë bërë kërkesë me 10.02.2026 respektivisht 20.02.2026, kanë parashtruar kërkesë në organin punëdhënës, ndërsa kanë qenë të detyruar të presin 45 ditë përgjigjen, ashtu siç përcaktohet me nenin 98 të Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe tutje nëse organi i punëdhënës nuk kthen përgjigje të veprojë sipas paragrafit 4 të 127 të LPPA i cili është sqaruar më lartë në këtë arsyetim, prandaj ankesa si e tillë nuk i plotëson kushtet ligjore për shqyrtim dhe si rrjedhojë hedhet poshtë si e pa lejuar.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA. A.NR.372/2026**

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve, Avokatit z. Mërgim Himaj;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.